



**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.
ZYRTARI I AUTORIZUAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

RELACION

Korçë më 02.12.2024

Ne lidhje me vendimin e Autoritetit Kontraktor “Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Korce Sh.a (UKRK SH.A.)” per zhvillimin e procedures me objekt “Furnizim dhe instalim i pompave në Njësitë Maliq, Devoll dhe Korçë” me fond limiti **70.300.000 (Shtatedhjetë milion e tetëdhjetë mijë) Leke pa TVSH** pa ndarje ne lote sqarohet se fillimisht eshte konceptuar qe pavaresisht llojit te procedures “mallra”, ne vleren totale te perlllogaritur te perfshihet dhe montimi i tyre nga ana e Operatorit Ekonomik/Bashkimit te Operatoreve Ekonomike qe do te shpallet fitues. Duke llogaritur vleren e pergjithshme te fondit limit vlera e mallrave te kerkuar ze 99% dhe pjesa tjetere jane sherbime. Ndodhur para faktit qe kjo vendimarrje perben rastin kur furnizimi i mallrave perfshin dhe montimin e tyre bazuar ne nenin 17/1 te Ligjit Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar eshte rasti i furnizimeve te perziera kur furnitori merr persiper edhe sherbimet per montim, cka sikunder u permend me lart eshte llogaritur dhe perfshire ne cmimin e blerjes se mallrave.

Duke patur parasysh gjendjen e amortizuar te mjeteve te stacioneve te pompimit, kerkesat per rinovimin e tyre duke i pershtatur me standarte te reja si dhe duke llogaritur rritjen e efciences se furnizimit me uje dhe uljen e kostove vecanerisht ate te energjise elektrike u vendos qe furnizimi dhe montimi do te behen ne menyre te tille qe cdo stacion pas rinovimit te jete i gatshem per funksionim sipas parametrave te kerkuara. Autoriteti Kontraktor nuk ka parashikuar vetem nje furnizim ose blerje malli por furnizimin dhe motimin ne cdo stacion gradualisht sipas nje grafiku qe do te behet sipas sektoreve per shkak te shtrirjes se madhe territoriale te vendeve ku ushtron veprimtarine Autoriteti Kontraktor.

Eshte parashikuar qe per shkak te llojit te mallrave te kerkuara sherbimi i montimit te kryhet nga OE/BOE te shpallur fitues me qellimin qe i gjithe procesi nga fillimi i furnizimit deri ne perfundim te sherbimeve te motimit te kryhet nga nje OE/BOE, pasi ndarja ne lote sipas zerit te mallrave do te sillte “mbivendosje” te ofrimit te furnizimit dhe sherbimeve dhe si pasoje do kishte zgjatje te panevojshme te afatit te realizimit te

kontrates si dhe dem per Autoritetin Kontraktor, i cili ka qellim paresor prodhimin dhe shperndarjen e ujit te pijshem. Ne kete rast demi do te shtrihej drejperdrejt tek konsumatori.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor eshte analizuar i gjithe procesi i furnizim-vendosjes dhe rezulton se te gjithe mallrat e kerkuara jane teresisht te lidhur ngushte me njera-tjetren ne menyren e funksionimit dhe eshte e pamundur ndarja ne lote.

Sa me siper perfundimisht Autoriteti Kontraktor ka vendosur zhvillimin e kesaj procedure pa ndarje ne lote duke e çmuar te pamundur dhe te demshme sipas parashikimeve te nenit 42/1 te VKM Nr.285, date 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar.

Hartoi

Ada Lumani Jurist

Resmir Rrezhda Inxhinier Elektrik

Edmond Shaholli Inxhinier Mekanik